



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 30, Datë 16.02.2023

MBI

**MIRATIMIN E AMENDIMIT NR. 1 TË KONTRATËS PËR SHITBLERJEN E
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË SISTEMIN E
TRANSMETIMIT NDËRMJET OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
OST SH.A. DHE KESH SH.A.**

Në zbatim të neneve 16, 20 gërma “h”, 47, 56 gërma “f”, si dhe 90 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; Pjesës I, nenit 4, pikës 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; VKM-së 650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 584, datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.02.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 420/1 prot., datë 14.02.2023, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi amendimin e kontratës për shit blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 230, datë 12.09.2022 miratoi kontratën e shit-blejes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a. për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit për periudhën 02.07.2022 deri më 31.12.2022. Kontrata e miratuar nga ERE i ka shtrirë efektet juridike nga 02.07.2022 deri më 31.12.2022.
- Palët kanë shprehur vullnetin e tyre për amendimin e kontratës duke e nënshkruar bashkërisht atë, për ndryshimin e kohëzgjatjes së kontratës, dhe shtrirjen e efekteve të saj deri më datë 30.06.2023, duke përcjellë kontratën në ERE me shkresë të përbashkët ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., me nr. 420 prot. të ERE, datë 20.01.2023 “Për amendimin e kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit”, të miratuar dhe nënshkruar ndërmjet palëve OST sh.a dhe KESH sh.a.

- Ndryshimi i kohëzgjatjes së kontratës, vjen si pasojë e zgjatjes së periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri më datën 30.06.2023, sikurse shprehur në VKM-në nr. 650, datë 10.10.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 584, datë 08.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike (të ndryshuar)”.
- VKM nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 584, datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, e ndryshuar, në pikën 2 përcakton se në pikën 5 fjalët “*deri në 31 dhjetor 2022*” zëvendësohen me fjalët “*30 qershor 2023*”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Amendimit nr. 1 të kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike për për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST sh.a. dhe KESH sh.a. (Amendimi bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 01.01.2023 deri më 30.06.2023.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI